

Përshëndetje,

Në vijim të kërkesës së ardhur për informacion, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

1. Referuar kërkesës së parë : " *Listën e pozicioneve vakante/shpallura që nga 01.09.2025, në kompetencë të Ministrisë*", ju informojmë se në zbatim të VKM-së nr. 16, datë 09.01.2025, " Për planin vjetor të pranimi për vitin 2025, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil", I ndryshuar dhe VKM-së nr. 39, datë 21.01.2026, " Për planin vjetor të pranimi, për vitin 2026, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil", ka shpallur pozicionet më poshtë të listuara për periudhën shtator 2025 dhe vijim:

- **Për vitin 2025**

Për periudhën shtator 2025-dhjetor 2025 nuk ka patur pozicione të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues të shpallura në faqen zyrtare të DAP. Vlerësojmë të saktësojmë se pozicioni Drejtor i Drejtorisë së Përkthimit Zyrtar për Bashkëpunimin Ndërgjyqësor dhe Certifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë , në Ministrinë e Drejtësisë, shpallur me kodin 6760 është publikuar në datën 20.12.2024.

- **Për vitin 2026**

7468- Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Drejtësisë, klasa e pagës III-1 (shpallur në datën 23.01.2026);

7472- Drejtor i Drejtorisë së Integritit dhe Negociatave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë, Integritit dhe Negociatave, në Ministrinë e Drejtësisë, klasa e pagës II-1 (shpallur në datën 28.01.2026).

2. Referuar kërkesës së dytë: "Fazën aktuale të secilit proces (në proces, mbyllur, etj.);", ju informojmë se të dyja procedurat e konkurrimit me kod 7468 dhe 7472 janë në proces. Ky informacion mund të merret lehtësisht në faqen zyrtare të DAP.

3. Referuar kërkesës së tretë: " Strukturat e përfshira në proces" ju informojmë se në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, " Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, " Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese",

i ndryshuar, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.

Këto procedura organizohen nga njësia përgjegjëse DAP, për një ose disa pozicione të lira të gjashme, bazuar në parimin e përmendur në nenin 20, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira;

b) vlerësimi i kandidatëve.

Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i pranimit, që ngrihet nga njësia përgjegjëse.

Për procedurën e lëvizjes paralele njësia përgjegjëse DAP urdhëron ngritjen e Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele (KPLP), i cili ka në përbërje 3 (tre) anëtarë:

a) 1 (një) përfaqësues nga institucioni, për të cilin është shpallur vendi vakant, i të njëjtit nivel ose i njëniveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet, kur është e mundur, i caktuar nga DAP-i;

b) eprorin direkt;

c) 1 (një) përfaqësues nga DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore.

Për procedurën e ngritjes në detyrë njësia përgjegjëse DAP urdhëron ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), i cili ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë:

a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;

b) Për institucionet e administratës shtetërore, 1 (një) anëtar nga institucioni që ka vendin vakant, pjesëe kategorisë së mesme drejtuese, i përcaktuar nga DAP-i. Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, 1 (një) anëtar, i zgjedhur nga titullari, midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur, të nivelit të mesëm drejtues;

c) Eprorin direkt të pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi;

ç) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimi

4. Referuar pyetjes së katërt: " Kriteret ligjore/procedurale të përzgjedhjes", ju informojmë se për procedurat e konkurimit të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionet e nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues, kriteret ligjore janë të përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 dhe VKM-së VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë. Mund të aplikojnë për këto procedura:

- a) nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira nëpërmjet lëvizjes paralele;
- b) nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë

Në përfundim të vlerësimit, komitetet mund të vendosin: a) përzgjedhjen e kandidatit që është renditur i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve; apo b) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 70 për qind të pikëve.

5. Referuar pyetjes së pestë: " Afatet e parashikuara për përfundimin e proceseve dhe plotësimin e vendeve vakante", bëjmë me dije se afatet e procedurave të konkurrimit janë të përcaktuara në Kreun II dhe III, të VKM-së nr. nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar.

6. Referuar pyetjes së gjashtë: "Nëse CV-të dhe dokumentacioni profesional i kandidatëve janë publike;

Ku mund të aksesohen (faqe zyrtare, njoftime publike, etj.);Nëse jo, bazën ligjore për mosbërjen publike të tyre", vlerësojmë t'ju sqarojmë se aplikimet kryhen në sistemin online të rekrutimit. Çdo kandidat krijon një llogari personale në sistem, të cilën e plotëson me të dhënat e kërkuara për aplikim dhe ngarkon dokumentacionin e përcaktuar në shpalljen përkatëse të procedurës së konkurrimit.

Për rrjedhojë, dosja e secilit kandidat që aplikon në sistemin online të rekrutimit, e cila përmban të dhëna personale dhe dokumentacion mbështetës, nuk është publike. Për çdo procedurë konkurrimi, DAP, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, verifikon plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe kërkesave të posaçme për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Në funksion të garantimit të transparencës së procesit të konkurrimit, publikohen listat me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kualifikohen për fazat e mëtejshme të procedurës, si dhe emrat e kandidatëve të shpallur fitues në përfundim të saj.